



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Bordi i Administrimit

Nr. 2457 Prot

Shkodër, më 12. 10. 2020

V E N D I M

Nr. 316 datë 12.10. 2020

" Për zgjatjen e marrëdhënies së punës"

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 49, ligjit nr.7961 dt.12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), ligjit 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 4 pika 19 pasi shqyrtoi kërkesën e znj. Suzana Gjurgjeje

VLERËSON

Zj. Zana Gjurgjeje, është aktualisht në pozicionin e përgjegjëses së Njesisë së Brendshme të Auditimit të USH. Ka përvojë si audituese 11 vite në këtë institucion. Nga të cilat 11 vite në drejtimin e njesisë. Zj. Zana Gjurgjeje ka mbushur moshën për pension pleqërie. Dhe ka paraqitur Bordit të Administrimit të USH, një kërkesë dt 30.09.2020, ku kërkon që ky organ në cilësinë e titullarit të shtyjë kohën e daljes në pension. Bordi i Administrimit duke vlerësuar se:

1. Njësia e Brendshme e Auditimit krijon siguri objektive për menaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njesisë publike. Kështu ky rol do ishte i pamundur të realizohej në periudhën që struktura audituese do të jetë e paplotësuar dhe funksionale me dy audituesit e mbetur, deri në zhvillimin e konkursit të rekrutimit të anëtarit të ri të njesisë.

2. Zj. Gjurgjeje aktualisht, është e angazhuar në veprimtari audituese të pambyllura, të cilat i referohen detyrave specifike të auditimit, detyrave të ndryshme të auditimit ose rishikimit, proceseve dhe veprim-tarive, ku përfshihen shërbimet e sigurisë e të këshillimit.

3. Zëvendësimi i saj në pozicionin e drejtueses mund të mos rezultojë një proces i lehtë rekrutimi, duke patur parasysh kërkesat e ligjit që drejtuesi i njesisë së auditimit të brendshëm duhet të jetë i certifikuar si "Auditues i brendshëm" dhe të ketë përvojë pune 5 vjet si auditues i brendshëm ose i jashtëm.

Përfundimisht, duke vlerësuar se misioni i auditimit të brendshëm është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njesisë së sektorit publik, në mënyrë të pavarur dhe objektive, duke marrë në konsideratë pozicionin dhe vitet e eksperiencës së Zj. Gjurgjeje, si dhe kërkesat ligjore të Kodi të Punës i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar) dhe ligjit 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik",



VENDOSI

Miratimin e kërkesën e znj. Suzana Gjurgjej me detyrë përgjegjëse e njësisë së auditit në USH-së për zgjatjen e marrëdhënies së punës për një vit.

Ngarkohet Administratori për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT

NAMIK KOPLIKU

